



**Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi
ndërmjet
Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë
dhe
Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë**

Prokuroria e Republikës së Bullgarisë dhe Prokuroria e Republikës së Shqipërisë, të referuara më poshtë si "Palët", me qëllimin për t'u kushtuar vëmendje të veçantë përpjekjeve për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut dhe duke pasur parasysh mirëkuptimin e tyre të ndërsjellët në lidhje me forcimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit, si dhe mirëkuptimin e tyre të ndërsjellët mbi nevojën për bashkëpunim të efektshëm, kanë rënë dakord sa më poshtë vijon:

Neni (1)

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit, brenda juridiksioneve të tyre, dhe në përputhje me legjislacionet dhe angazhimet e tyre që rrjedhin nga akte ligjore ndërkombëtare.

Neni (2)

Palët bien dakord, me marrëveshje të ndërsjellët, të zhvillojnë takime dhe konsultime për shkëmbimin e eksperiencës në lidhje me aktivitetet e tyre dhe për të diskutuar çështje me interes të përbashkët.

Neni (3)

Palët bien dakord, brenda juridiksioneve të tyre, të bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacion dhe zhvilluar konsultime për përgatitjen dhe zbatimin e kërkesave për ndihmë juridike dhe veprime të tjera, për aq sa ato janë të zbatueshme brenda fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Neni (4)

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e trajnimeve profesionale dhe ngritjes së kapacitetit të prokurorëve në Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Shqipërisë.

Neni (5)

Palët mund të shkëmbejnë informacionin që lejon ose kontribuon në hetimin ose parandalimin e veprimtarive kriminale, sipas nevojave specifike.

Neni (6)

Palët bien dakord të përgatisin, me marrëveshje të ndërsjellët, kërtime të përbashkëta shkencore dhe të zhvillojnë konferenca dhe seminare për çështje të rëndësishme që lidhen me prokuroritë e Republikës së Bullgarisë dhe të Republikës së Shqipërisë.

Neni (7)

1. Palët bien dakord që të komunikojnë drejtpërsëdrejti për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi;
2. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në kuadër të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, nëpërmjet:
 - a. Nga ana e Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë: Departamenti Ndërkombëtar në Prokurorinë e Lartë të Kasacionit.
 - b. Nga ana e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë: Departamenti i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë.

Palët bien dakord që të njoftojnë njëra tjetrën në mënyrë të rregullt në rast të ndonjë ndryshimi në lidhje me departamentet e mësipërme; dhe

3. Secila Palë merr përsipër, brenda tridhjetë ditëve nga nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi, të njoftojë Palën tjetër lidhur me adresat, numrat e telefonit, numrat e faksit dhe adresat elektronike (e-maillet) të punonjësve përgjegjës për të ruajtur bashkëpunimin ndërmjet dy Palëve.

Neni (8)

1. Secila palë bie dakord të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për të ruajtur konfidenciale të gjithë informacionin, duke përfshirë dokumentet e marra, në rast të një kërkesë të dërguar nga Pala tjetër;
2. Secila Palë bie dakord të ruajë nivelin e konfidencialitetit, sikurse kërkohet nga Pala tjetër, në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës; dhe
3. Pala e cila kërkon dokumente dhe informacion, në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi, mund t'i përdorë këto dokumente dhe informacion për qëllime të ndryshme nga ato të specifikuara në kërkesë, pa nevojën e miratimit paraprak nga Pala që ofron këto dokumente dhe informacion.

Neni (9)

Secila Palë do të mbulojë kostot dhe shpenzimet e veta të bëra gjatë zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, përveçse kur bihet dakord ndryshe në rastin përkatës.

Neni (10)

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi zgjidhen nëpërmjet konsultimeve.

Neni (11)

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndryshohet me mirëkuptim të ndërsjellët ndërmjet Palëve.

Neni (12)

Memorandumi i Mirëkuptimit nuk prek të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ndonjë marrëveshje tjetër e këtij lloji e nënshkruar ndërmjet Palëve.

Neni (13)

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk kufizohet me një afat të caktuar dhe hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj;
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi pushon së qeni në fuqi 60 ditë pas ditës kur secila nga Palët dërgon një njoftim me shkrim ku informon mbi dëshirën e saj për të ndërprerë Memorandumin e Mirëkuptimit; dhe
3. Ndërprerja e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk ndikon në përmbushjen e ndonjë angazhimi të bërë gjatë kohëzgjatjes së Memorandumit të Mirëkuptimit, përveçse në rastet kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni (14)


Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ky Memorandum nuk krijon të drejta dhe detyrime për Palët.

Nënshkruar në Sofje, më 26/09/2018 në dy origjinale në gjuhën bullgare, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretimin e këtij memorandumi, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Prokurorinë e
Republikës së Shqipërisë

Për Prokurorinë e
Republikës së Bullgarisë

ARTA MARKU
PROKURORE E PËRGJITHSHME



SOTIR CACAROV
PROKUROR I PËRGJITHSHËM

